



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:194335

Datë: 19.11.2024

Numri i dokumentit: 06476612

C.nr.5116/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Albana Çeku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.L, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, avokat I.T me seli në , kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë (DKA), me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore (ushqimit), jashtë seancës gjyqësore, më datë 19.11.2024, mori dhe përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditëses H.L dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë (shujtave ditore), nga data 18.04.2021 e deri me datë 20.11.2022 për 286 ditë pune, t'ia kompensoi shumën prej 572.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, datë 13.09.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124,00 €, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë me datën 13.09.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, për kompensimin e shujtave ditore (ushqimit), gjatë punës sipas nenit 35 par.7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me dt.22.01.2021.

Ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura si mësimdhënëse në SHFMU “....” në P. Ka shtuar se paditësja nga data 18.04.2021 e deri me datën 20.11.2022 për kohën që kjo kontratë ka qenë në fuqi nuk është kompensuar me nga dy euro, për secilën ditë të pranisë në punë edhe pse kjo e drejtë i është garantuar.

Paditësja gjatë kësaj periudhe kohore ka punuar nga 286 ditë pune e nëse përllogaritet secila ditë pune me nga dy euro atëherë shuma që do të duhet të kompensohej paditëses ne emër të shujtave ditore –ushqimit në punë do të ishte në lartësi prej 572.00 €.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të pranuar në gjykatë me datë 07.11.2024 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses me pretendimin se kompensimet e tillë nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, e po ashtu e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Po ashtu, në rastin konkret ekziston edhe parashkrimi i kërkesës pasi konform dispozitave të Ligjit të Punës të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkuhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku parashihet se: “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*”, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: “*Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj*”, kjo pasi që në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditëses aprovohet në tersi si e bazuar, për arsyen se:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se, në mes të palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga kontrata e punës me numër të protokollit 61 e datës 01.09.2009 dhe vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë me numër të protokollit nr.prot.170/23 datë 19.07.2023.

Gjykata nga vërtetimet mbi ditët e pranisë në punë me numër të protokollit nr.prot.4170/23 datë 19.07.2023 vërtetoi se sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë e paditësja për periudhën nga data 18.04.2021 e deri me datë 20.11.2022 ka realizuar gjithsej 286 ditë pune.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Kjo përfaktin se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e shpenzimeve të shujtave ditore (ushqimit) për periudhën kohore nga data 18.04.2021 e deri me datë 20.11.2022 gjenë mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, shprehimisht parashihet; “*Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy 2.00 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në Institucionet Arsimore*”. Mbi këtë bazë e duke u bazuar në vërtetimin e ditëve të prezencës në punë, nga të cilat rezulton që paditësja ka qenë prezentë në punë gjithsej 286 ditë për periudhën të cilën kërkon kompensimin e që i bie se për 286 ditë pune nga 2 euro ($286 \times 2.00 =$), vlera totale e kompensimit për ushqim gjatë është 572.00 €.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në atë se, kompensimet e tillë nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, kërkesëpadia e paditësit përmban kërkesa të parashkruara si dhe lidhur me faktin se gjatë përgatitjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje kompensimit. Sa i përket pretendimit të parë, gjykata vlerëson se e drejta e paditësit për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 paragrafi 1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: “*Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur*”.

Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e kësaj kontrate, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas kontratës kolektive të lartcekur, në njëren anë janë paraparë të drejta për njëren palë, e në anën tjetër janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditësit për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Gjykata e ka vlerësuar edhe pretendimin e te paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës se paditëses, mirëpo një pretendim i tillë rezulton i pabazuar për faktin se paditësja me padi ka kërkuar kompensimin e shujtave ditore për periudhën 18.04.2021 deri me 20.11.2022, ndërsa padinë e ka parashtruar me datën 13.09.2023, e që i bie se padia është parashtruar brenda afatit tre (3) vjeçar të përcaktuar me nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tillë, gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësi t'i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, dispozitat e së cilës janë të karakterit obligativ, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, gjykata ka vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ta paguajë së bashku me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila kamatë do të fillojë të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive të shumës si në pikën I të dispozitivit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç ‘rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€.

Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00 €, si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 €.

Bazuar në të lartcekurat, në bazë të nenit 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.5166/2023, datë 19.11.2024

G j y q t a r j a
Albana Çeku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.